



UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" UNIVERSITY

Zija Shemsiu, 60000, Gjilan, Kosovë

www.uni-gjilan.net tel: 0280-390-112

SYLLABUS

LËNDA: *E drejta e procedurës penale-Pjesa e përgjithshme*

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Juridik
Titulli i lëndës:	<i>E drejta e procedurës penale-Pjesa e përgjithshme</i>
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti i III-të, Semestri IV-të
Numri i orëve në javë:	2+1
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	Ligjërata: Ushtrime Asistent: Fatmire Krasniqi
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. ass. dr. Fejzullah Hasani
Detajet kontaktuese:	fhasani60@hotmail.com , tel: 045-321-690
Përshkrimi i lëndës	
	<i>E drejta e procedurës penale</i> është pjesë e shkencës juridike penale e cila i kontribuon luftës së suksesshme kundër kriminalitetit. Në bazë të plan-programit mësimor të <i>Fakultetit Juridik</i> të Universitetit "Kadri Zeka" në Gjilan, lënda <i>E drejta e procedurës penale</i>, si lëndë e obligueshme në vitin shkollor 2019/2020, ligjërohet në semestrin e pestë dhe përfshinë njësitë e zgjedhura mësimore që lehtësojnë arritjen e njohurive mbi çështjet që i referohen objektit të së drejtës së procedurës penale, subjekteve të kësaj procedure, parashtresat, masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë penale si dhe provat.

Qëllimet e lëndës:	Ky program mësimor mundëson përvetësimin dhe thellimin e njohurive nga <i>E drejta e procedurës penale</i>, e cila si pjesë e shkencës juridiko-penale, në kuptimin e gjerë të fjalës i kontribuon luftës kundër kriminalitetit. Programi mësimor nga lënda <i>E drejta e procedurës penale</i>, do të shtjellohet në aspektin teorik dhe atë praktik (nëpërmjet ligjëratave, përpilimin e shkresave proceduralo-penale, seminareve, debateve dhe diskutimeve me studentë). Qëllimet e lëndës janë që studentët të njihen me autorizimet e subjekteve dhe palëve në procedurën penale, me të drejta dhe detyrimet e pjesëmarrësve në procedurën penale, mënyrat dhe mjetet për rrjedhën të papenguar të procedurës penale, masat për sigurinë e të pandehurit në procedurë pastaj masat për sigurimin e provave në procedurë, për formën e veprimeve, kohën dhe vendimin e veprimeve procedurale, për mbrojtësit dhe përfaqësuesit në procedurën penale, për mënyrën e vërtetimit të fakteve në procedurë, validitetin dhe jo validitetin e provave në procedurën penale. Qëllimi i këtij programi është gjithashtu përgatitja dhe aftësimi i studentëve që, si jurist të ardhshëm me lehtësi të përballen me sfidat e zgjidhjes së çështjeve të ndryshme me natyrë proceduralo-penale, të përpilojnë me lehtësi shkresat proceduralo-penale, të adresojnë drejtë çështjet që lidhen me kompetencat e organeve të procedurës penale dhe kështu t'i kontribuojnë luftës parandaluese të kriminalitetit.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Me trajtimin e njësive të caktuara të së drejtës së procedurës penale, studentëve u ofrohet materia përkatëse që të kuptojnë dhe zgjerojnë njohuritë dhe përmbajtjet kryesore shkencore. Vëzhgimi i aktiviteteve të studentëve dhe debatet e zhvilluara në këtë fushë, me trajtimin e rasteve konkrete nga praktika e organeve proceduralo-penale, ka për qëllim aftësimin e studentëve në lëmin e kësaj shkençe. Në sistemin e mësimi zbatohen metodat e shtjellimit të lëndës ashtu që organizohen debate, teste, seminare e kolokviume me qëllim të nxitjes së punës aktive në zhvillimin e procesit mësimor. Me këto metoda mësimore, studenti që kryen fakultetin juridik aftësohet me njohuri themelore rreth mënyrës së veprimit të gjykatave dhe

	organeve tjera të procedurës penale në zgjidhjen e drejtë të çështjeve penale. Vlerësimi i studentit gjatë kohës së ligjëratave bëhet edhe me testim. Kështu, çdo muaj organizohen testet e vlerësimit. Pas përfundimit të këtij kursi studenti do të jetë në gjendje që: - Të dallojë qartë çështjen penale nga çështjet tjera të kundërligjshme, - Të zgjidhë çështjen e kompetencës së gjykatës, - Të hartojë shkresa të ndryshme me natyrë proceduralo-penale si dhe - Të kualifikojë sipas rëndësisë që kanë për zgjidhjen e drejtë të një çështje penale provat, e kështu me radhë.		
Kontributi në ngarkesën e studentit (duhet të korrespondojë me rezultatet e tënxënittë studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	1	15	15
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	0,5-1	30	15
Kollokfiume,seminare	3	2	6
Detyra të shtëpisë	/		/
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	15	15
Përgatitja përfundimtare për provim	3	15	30
Koha e kaluar në vlerësim (teste, provim final)	1	5	5
Projektet, seminare, prezantimet ,etj	1	2	2
Totali			118
Metodologjia e mësimdhënies:	Ligjërata interaktive: Bashkëbisedim-duke ju mundësuar studentëve parashtrimin e pyetjeve, diskutimin dhe këmbimin e mendimeve të tyre lidhur me çështjet e ndryshme tematike.		
	Punime seminarike: Aktivitete të studentëve. Studentët mund të		

	përcaktohen për studimin e ndonjë temë apo punimi seminari. Para fillimit të punës së tyre atyre ju ofrohen udhëzimet elementare, ndërsa pas përfundimit ju ofrohet mundësia e prezantimit të punimeve të tyre para studenteve të tjerë. Pas prezantimit të këtyre seminareve zhvillohet debat interaktiv lidhur me temat e shtjelluara dhe në fund behet vlerësimi i punimit. Puna grupore: Debat shkencor. Gjatë trajtimit të temave të ndryshme, studentët mund të ndahen në dy ose me shumë grupe, më qëllim të zhvillimit të debateve interaktive dhe konstruktive shkencore. Metodat e ligjërimit: Zakonisht do të aplikohen metoda bashkëkohore të ligjërimit, të cilat praktikohen në universitetet e ndryshme evropiane: prezantimi i temës përmes Power Point, raste studimi dhe detyra mësimore – studimore lidhur me temën e ligjëruar.
Metodat e vlerësimit:	Testi i parë: 30 pikë Testi i dytë: 50 pikë Detyrat e shtëpisëprezantimet: max.5 pikë Vijimi i rregullt dhe aktiviteti në klasë: MAX. 5 pikë Seminari .max.10 pikë Provimi përfundimtar: 50 pikë Totali: 100 pikë. Vlerat e pikëve: Provimi ka 100 pikë. 50-60 = 6; 61-70 = 7; 71-80 = 8; 81-90= 9; 91-100 = 10 Nëse numri total i pikëve të studentit, duke përfshirë testet, prezantimet, vijueshmërinë dhe provimi final, është më pak se 50 pikë, studenti nuk e kalon provimin.
Literatura	

Literatura bazë:	Hajdari A., <i>E drejta e procedurës penale-Pjesa e përgjithshme</i>, Prishtinë, 2016. Sahiti E. dhe Murati R., <i>E drejta e procedurës penale</i>, Prishtinë, 2014 si dhe Hajdari A., <i>E drejta e procedurës penale e të miturve</i>, Prishtinë, 2005.
-------------------------	---

Literatura shitesë:	<i>Komentari i Kodi të Procedurës Penale</i> (Ejup Sahiti, Rexhep Murati dhe Xhevdet Elshani) <i>Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës (2013)</i>, <i>Kodi i procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë</i>, Samaha J., <i>Criminal procedure</i>, Boston, 2014, Rolando V. <i>Criminal Procedure: Law and Practice</i>, New York, 2016, Samaha J., <i>Criminal procedure</i>, Boston, 2014, Rolando V. <i>Criminal Procedure: Law and Practice</i>, New York, 2016, SwansonCh. <i>Criminal Investigation</i>, London, 2014, Fausto I. <i>E drejta procedurale penale</i>, Përkthim, Tiranë, 2002. Grigor Gj. <i>Procedura penale e RPSH</i>, Pjesa e posaçme, Tiranë, 1970, Grubač M. <i>Krivično procesno pravo</i>, Posebnideo, Beograd, 2004, Hajdari A. <i>Komentar- Kodi i procedurës penale</i>, Prishtinë, 2016, Hajdari A. <i>E drejta e procedurës penale- Komentar</i>, Prishtinë, 2010. Islami H. etj. <i>Procedura penale</i>, Tiranë, 2003, Matovski N. <i>Kazнено procesno pravo</i>, Skopje, 2004, NovaK. <i>Proçedura penale</i>, Pjesa e përgjithshme, Tiranë, 1966, Panta M. <i>Komentarot na zakonota krivična tapostopka</i>, Skopje, 1979, Pavišić B. etj. <i>Zakon o kaznenom postupku</i>, Zagreb, 1998, Sahiti E. Murati R., Elshani Xh., <i>Komentar – Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës</i>, Prishtinë, 2014, Sierčić Č. <i>Krivično procesno pravo</i>, Sarajevo, 2005 Stevanović Č i dru. <i>Krivično posebno pravo</i>, Beograd, 1997.
----------------------------	---

Plani i dizajnuar i mësimi:

Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë:	Nocioni i të drejtës së procedurës penale Lënda e të drejtës së procedurës penale E drejta e procedurës penale si degë e legjislacionit pozitiv E drejta e procedurës penale si degë e shkencës juridike E drejta e procedurës penale dhe mundësitë e realizimit të të drejtave të njeriut në tipat themelor historik të procedurës penale Tipi akuzator i procedurës penale

	Disa nga karakteristikat themelore të tipit akuzator të procedurës penale Anët pozitive dhe negative të tipit akuzator të procedurës penale Tipi inkuizitor i procedurës penale Disa karakteristika themelore të tipit inkuizitor të procedurës penale Anët pozitive dhe negative të tipit inkuizitor të procedurës penale Tipi i përzier (mikst) i procedurës penale Disa karakteristika themelore të tipit të përzier të procedurës penale
Java e dytë:	MARRËDHËNIET E TË DREJTËS SË PROCEDURËS PENALE ME TË DREJTËN PENALE Marrëdhëniet e të drejtës së procedurës penale me të drejtën e ekzekutimit të sanksioneve penale Marrëdhëniet e të drejtës së procedurës penale me të drejtën e procedurës civile Marrëdhëniet e të drejtës së procedurës penale me disa degë tjera të së drejtës Marrëdhëniet e të drejtës së procedurës penale me procedurat tjera ndëshkuese Marrëdhëniet e të drejtës së procedurës penale me mjekësinë ligjore Marrëdhëniet e të drejtës së procedurës penale me psikiatrinë gjyqësore Marrëdhëniet e të drejtës së procedurës penale me psikologjinë gjyqësore
Java e tretë:	Veprimi i legjislacionit procedural penal në territor Veprimi i legjislacionit procedural penal në kohë Veprimi i legjislacionit procedural penal në lidhje me personin Imuniteti procedural penal Imuniteti i personaliteteve të caktuara të institucioneve të Kosovës Imuniteti i personave të huaj Interpretimi i të drejtës së procedurës penale PARIMET NË PROCEDURËN PENALE Parimi zyrtar (oficialitetit) i ndjekjes penale Parimi i ligjshmërisë Parimi akuzator Parimi i prezumimit (supozimit) të pafajësisë së të pandehurit dhe in dubio pro reo Parimi i gjykitimit të drejtë, të paanshëm dhe në kohë të arsyeshme Parimi i respektimit të integritetit personal dhe të drejtave të të akuzuarit Parimi i të vërtetës materiale Parimi kontradiktor Parimi i barazisë para ligjit Parimi i drejtpërdrejtë Parimi gojor dhe i gjuhës në procedurë penale Parimi i publicitetit
Java e katërt:	OBJEKTI PARËSOR (THEMELOR) I PROCEDURËS PENALE OBJEKTI DYTËSOR (SEKONDAR) I PROCEDURËS PENALE Kërkesa pasurore juridike Çështja prejudikuese Shpenzimet e procedurës penale SUBJEKTET THEMELORE TË PROCEDURËS PENALE Gjykata

	Llojet, funksionet dhe përbërja e gjykatës Parimet mbi organizimin dhe veprimtarinë e gjykatave Kushtet për emërimin dhe shkarkimin e gjyqtarëve Përgjashtimi i gjyqtarëve dhe gjyqtarëve porotë Kompetenca e gjykatave Kompetenca lëndore Kompetenca dhe përbërja e gjykatës themelore Kompetenca dhe përbërja e Gjykatës së Apelit Kompetenca dhe përbërja e Gjykatës Supreme Kompetenca territoriale Kriteret parësore të përcaktimit të kompetencës territoriale Kriteret dytësore të përcaktimit të kompetencës territoriale Kompetenca personale Kompetenca funksionale Bashkimi dhe veçimi i procedurës Kontrolli i kompetencës dhe vlerësimi i kompetencës Kontrolli i kompetencës Konflikti i kompetencës Ndihma juridike
Java e pestë:	Palët procedurale penale Prokurori i shtetit Parimet e organizimit dhe veprimtarisë së prokurorit të shtetit Parimi i pavarësisë Parimi i paanshmërisë Parimi i përbërjes shumetnike dhe barazisë gjinore Parimi i efikasitetit Dsa parime të tjera specifike të organizimit dhe veprimtarisë së prokurorit të shtetit Disa çështje të tjera procedurale që kanë të bëjnë me prokurorin
Java e gjashtë:	TESTI I PARË
Java e shtatë:	I pandehuri Mbrojtësi Pjesëmarrësit tjerë në procedurë penale I dëmtuari Përfaqësuesit proceduralë Ndihmësit proceduralë Vendi i përpilimit të parashtresave Koha e përpilimit të parashtresave Kërkesa për kthim në gjendje të mëparshme Parashtresat penale Llojet e parashtresave me natyrë penale Procesverbali Regjistrimet me video e audio incizim dhe stenografimi i transkriptit

Java e tetë:	Aktet akuzuese Kallëzimi penal Propozimi i të dëmtuarit për ndjekje penale Aktakuza Propozimi i arsyetuar i prokurorit për shqiptimin e masës edukative apo të dënimit ndaj të miturit Propozimi i prokurorit të shtetit për shqiptimin e masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik
Java e nëntë:	Aktet gjyqësore Aktgjykimi Aktvendimi Urdhri Marrja dhe komunikimi i vendimeve Forma e prerë dhe ekzekutueshmëria e vendimeve Forma e prerë e vendimeve Ekzekutimi i vendimeve Disa lloje tjera të parashtresave Dërgimi i parashtresave Shikimi i parashtresave (shkresave)
Java e dhjetë:	Masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurën penale Thirrja gjyqësore Urdhërarresti Premtimi i të pandehurit se nuk do të braktisë vendqëndrimin Ndalimi për t'iu afruar vendit ose personit të caktuar Paraqitja në stacionin policor Dorëzania Arresti shtëpiak Diversioni Paraburgimi Zbatimi i paraburgimit
Java e njëmbëdhjetë:	Masat për sigurimin e provave materiale dhe të interesave pasurore Kontrollimi Kontrollimi i shtëpisë dhe i personit Masat e fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit Sekuestrimi i sendeve Këqyrja dhe rikonstruksioni Identifikimi i personave dhe sendeve. Ngrirja e aseteve dhe urdhrat ndalues Masat e përkohshme për sigurimin e pasurisë
Java e dymbëdhjetë:	Kuptimi i provës Mjetet e provës Klasifikimi i provave Objekti i të provuarit Barra e provës Provat e papranueshme dhe pasojat juridike të përdorimit të tyre

	Provat e papranueshme Veçimi i provave të papranueshme nga shkresat e lëndës dhe pasojat e përdorimit të tyre
Java e trembëdhjetë:	Dëshmitarët okular Dëshmitarët sipas dëgjimit Dëshmitarët bashkëpunues Dëshmitarët me nevoja të veçanta Zbatimi i marrjes në pyetje të dëshmitarit Ballafaqimi i dëshmitarë
Java e katërbëdhjetë:	Mbrojtja e dëshmitarëve dhe të dëmtuarve Ekspertimi–vështrime të përgjithshme Çaktimi i ekspertit Raporti i ekspertit dhe specifikat tjera që ndërlidhen me të Llojet e ekspertimit Autopsia
Java e pesëmbëdhjetë:	Ekzaminimi i lëndimeve trupore dhe ekzaminimi fizik Analizat toksikologjike Analizat psikologjike Analizat molekulare dhe gjenetike dhe analizat e ADN-së Analizat financiare Analizat kompjuterike Ekspertimet kriminalistike Vlera provuese e ekspertizës Provat materiale Dokumentet si prova materiale Llojet tjera të provave materiale
Java e gjashtëmbdhjetë:	TESTI I DYTË